



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KUVENDI I KOMUNËS

01 Nr. 060/01-6948/2018

Datë. 30.03.2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e katërt e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2018, e mbajtur me datën 30.03.2018, me fillim në orën 10.00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi : Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Anton Shala .

Në mbledhje marrin pjesë 34 anëtarë të Kuvendit të Komunës: z. Haxhi Sejdiu, z. Nik Hyseni, z. Jusuf Osmani, z. Shaban Luma, znj. Teuta Pallaska –Milla, znj. Florentina Gjergjaj, znj. Albina Sadrija, z. Muharrem Musa, z. Faton Gutaj, znj. Diana Qarkaxhija, z. Basri Komoni, znj. Hana Zeka. , znj. Edi Puka, znj. Drita Buza - Zhaveli, z. Jeton Vorfi, z. Agon Batusha, z. Shpend Komnova , znj. Mimoza Shala , znj. Lirika Komoni, z. Krishnik Alijaj, z. Bekim znj. Miranada Lushaj, znj. Dafina Syla, , z. Bashkim Gashaj, z. Bekim Ermeni, z. Sadik Hoti, znj. Saranda Hoda, znj. Besarta Lekaj, z. Bekim Ermeni z. Anton Shala, z. Zef Komani, znj. Arjeta Gjoklaj, z. Fazli Hoxha, znj. Valentina Alijaj, z. Edmond Dushi .

Mungojnë : z. Halit Isufi , me arsye .

Të pranishëm të tjerë: Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, Nënkryetari i Komunës z. Ramadan Hoti, Drejtoret e Drejtorive Komunale, Komandanti i Stacionit policor ne Gjakovë z. Kristë Gjokaj, përfaqësues të ZKKK-së, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarët për informim, zyrtarë të tjerë Komunal, si dhe përfaqësues nga mediat e shkruara dhe elektronike dhe qytetarë të Komunës së Gjakovës.

Kryesuesi: I nderuar Kryetar i Komunës z. Ardian Gjini, Komandanti i Stacionit policor ne Gjakovë z. Kristë Gjokaj të nderuar anëtarë të pranishëm të Kuvendit të Komunës, Drejtor të drejtorive Komunale Të nderuar përfaqësues të Mediave, të OSBE, të nderuar të pranishëm.

Sot do ta kemi mbledhjen e katërt të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, dhe kemi Mbajtur edhe një mbledhje të jashtëzakonshme, ju njoftoj se të pranishëm në këtë mbledhje janë : 34, anëtarë, meqenëse kemi koriumin po fillojmë me mbledhjen .

Kryesuesi: Rendin e ditës për këtë mbledhje e keni marrë së bashku me ftesën dhe materialin e mbledhjes sipas afateve të përcaktuara ligjore andaj e hapi diskutimin a ka dikush ndonjë vërejtje ose sugjerim sa i përket pikave të rendit të ditës për këtë mbledhje.

z. Zef Komani : Sot kamë dalur këtu që të shprehi një breng dhe të kërkoj përkrahjen e juaj , që ka të bëjë me çështjen e arrestimit të 6 profesorëve të shkollës Mehmet Akif në Kosovë ku njëri nga ta ka qenë edhe drejtor i një shkolle në Gjakovë, kjo çështje mundet të diskutohet në tri aspekte , në aspektin Juridik, Politik dhe

Human andaj ne si Kuvend nuk kemi kompetenca të diskutojmë në aspektin Politik dhe Juridik por kërkoj që të diskutojmë në aspektin Human, sepse nxënësit e saj shkolle kanë qenë më të suksesshëm në Komunën e Gjakovës , andaj kërkoj që sot të miratohet një deklaratë të keqardhjes për këtë rast .

Kryesuesi: Për këtë çështje nëse pajtoheni do të diskutojmë në piken të Ndryshme , andaj e qes në Votim rendin e ditës sipas ftesës së bërë, kush është: për , kundër abstenim. Nga anëtarët e Kuvendmi të Komunës **unanimisht** u votua për rendin e ditës sipas ftesës së bërë

Pas votimit u miratua Ky :

REND DITE

- 1.Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 23.02.2018 dhe mbledhjes së Jashtëzakonshme të mbajtur me dt. 08.03.2018 .
- 2.Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit për periudhën Mars – Dhjetor 2018.
- 3.Informata e Kryetarit të Komunës për Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2018.
- 4.Miratimi i Planit të punës se KKSBB-se 2018.
- 5.Miratimi i Planit për transparence në Komunën e Gjakovës 2018.
- 6.Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës së Gjakovës për vitin 2017.
- 7.Bartja (rialokimi) i buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin 2018.
- 8.Themelimi i Komitetit për Shërbime Publike (KPSH).
- 9.Themelimi i Komisionit te Ankesave për dhënien ne shfrytëzim te pronës komunale .
10. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve për Teatrin e Qytetit “Hadi Shehu” në Gjakovë në Vlerë prej 26.000.00€.
11. Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 910/0, Zk Firzë në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).
12. Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 164/0, Zk Trakaniq në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).
13. Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1186/0, Zk Cermjanë në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).
14. Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1116/2, Zk Gjakovë qytet në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).
15. Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 113/0, Zk Pjetërshan në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).
16. Të Ndryshme .

1. Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 23.02.2018 dhe mbledhjes së Jashtëzakonshme të mbajtur me dt. 08.03.2018

Kryesuesi: Për këtë pik të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 23.02.2018 dhe mbledhjes së Jashtëzakonshme të mbajtur me dt. 08.03.2018, a ka dikush ndonjë vërejtje ose sugjerim sa i përket këtij procesverbali .

z. Agon Batusha: Unë kamë një çështje teknike tek Procesverbali nga Mbledhja e Jashtëzakonshme sepse z. Kreshnik Alijaj ka qen prezent në mbledhje dhe është shënuar gabimisht se ka munguar ndërsa ka

munguar znj. Hana Zeka dhe është shënuar qe ka marr pjesë andaj kërkoj që të përmirësohet, ndërsa tek fjalja ime kërkoj që të bashkëngjiten edhe rekomandimet që i kemi bërë.

Kryesuesi: E qes në Votimi miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 23.02.2018 dhe mbledhjes së Jashtëzakonshme të mbajtur me dt. 08.03.2018 me përmirësimet e kërkuara , **Kush është: Për, kundër, Abstenim**

Nga Anëtarët e Kuvendit të Komunës Unanimisht u miratuan procesverbalet e mbledhjeve të kaluara me përmirësimet e kërkuara.

2. Pika e dytë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit për periudhën Mars – Dhjetor 2018.

Kryesuesi: Për këtë pikë e kemi Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit për periudhën Mars – Dhjetor 2018, dokumenti është shqyrtuar edhe në mbledhjen e KPF-së dhe i është dërguar me kohë secilit anëtar të Kuvendit, Plani i Punës së Kuvendit sipas rregullit duhet të miratohet në përfundim të viti për vitin e ardhshëm, mirëpo për arsye se në këtë vit kemi pasur ndërrimin e pushtetit dhe nuk është miratua me kohë, dhe kjo është arsyeja që jemi vonuar për miratimin këtij plani andaj e hapi diskutimin për këtë pikë .E Hapi diskutimin për këtë pik të rendit të ditës.

z. Edmond Dushi: Konsideroj se përgjithësisht ky planë është në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka kuvendi dhe përfshinë shqyrtimin dhe miratimin e dokumenteve të rëndësishme për mbarëvajtjen e punëve në Kuvend dhe qeverinë komunale, që duhet të kontribuojnë në rritjen e mirëqenies së qytetarëve e që duhet të përfshihen në agjendën vjetore të Kuvendit dhe trupave të tij. Konsideroj se këtij plani i mungojnë edhe disa aktivitete që derivojnë nga LVL e që janë përgjegjësi e Kryetarit dhe e Kuvendit e që janë në funksion të rritjes së transparencës Komunale dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje e këto janë :

1. Kryetari i Komunës ë raporton para KK për situatën ekonomiko financiare të Komunës
 - 2.Çdo Komunë mban periodikisht së paku dy herë në vit ë takime publike në të cilat mund të marrin pjesë secili person apo organizatë me interes në Komunë
 3. Pas pranimit të propozim-buxhetit, Kuvendi i komunës duhet të mbaj dëgjime publike në përputhje me aktet ligjore
- Propozoj që pika 1 dhe 2 të përfshihen në Muajin Qershor dhe në muajin Dhjetor , ndërsa pika e 3 të përfshihet në muajin Shtator

Kryesuesi: Për pikën e parë të kërkesës raporte për situatën ekonomiko financiare ka mundësi të futet ndërsa për këto dy të tjera nuk është kompetencë e Kuvendit, E qes në votim miratimin e i Planit të Punës së Kuvendit për periudhën Mars – Dhjetor 2018, me këtë përmirësim, **Kush është: Për, Kundër, Abstenim** . Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro**, pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë:

V E N D I M

Për Planin e Punës së Kuvendit

1. Miratohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës për periudhën Mars – Dhjetor 2018.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës për periudhën Mars – Dhjetor 2018.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

3.Pika e tretë e rendit të ditës: Informata e Kryetarit të Komunës për Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2018.

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës kemi Informata e Kryetarit të Komunës për Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2018 , ku do të shpalosen programi dhe projektet që do të realizohen nga ekzekutivi i Komunës sipas drejtorive në vitin 2018 andaj e ftoj Kryeartin e Komune s z. Ardian Gjini që të merr fjalën .

Kryetari: Në këtë prezantim nuk do të ju flas për ato që janë prezantuar në dokumentet e juaja por nëse keni ndonjë pyetje atëherë do të ju përgjigjem unë dhe drejtorët përkatës. Ne jemi të fokusuar në rritjen të hyrave komunale dhe deri më tani për çdo muaj janë tejkaluar planifikimit kështu që jemi në rrugë të mirë, çështje tjetër është ndërtimi i sistemit të projekteve që janë fitimprurëse, do të vazhdojmë me projektet e rrugëve të kanalizimeve dhe projekte të trotuareve dhe projekteve që janë paraparë, sepse janë të miratuar në buxhetin i cili është miratuar në qeverisjen e kaluar dhe unë mendoj se aj buxhet ka qenë për me fillua çdo gjë dhe mos me përfunduar as gjë, por ne jemi të detyruar të vazhdojmë të paktën deri në rishikim një problem që kemi hasur është se janë 25 projekte që kanë mbetur pa u vazhduar qe 5 vite dhe është një problem serioz ligjore. Projekte fitimprurëse është Qarkorja e cila ka filluar do të vazhdojmë me rrugën Bujar Roka edhe pse nuk ka pasur projekt dhe nuk ka projekt do të harrojmë projektin dhe besojmë se në këtë vit do të vazhdojmë me atë rrugë sepse e kemi nënshkruar Memorandumin e bashkëpunimit me Ministrin e Infrastrukturës për 8 milion euro të cilat praktikisht e përmbyllin komplet rrjetin e dy qarkoreve dhe të hyrje daljeve pa pasur nevojë për kredi , përpos hyrje daljes nga Peja, jemi duke punuar për hartimin e projektit të rrugës deri tek maja e Kurorës, e cila ka filluar vitin e kaluar shumë me nxitim pa pasur mjete të parapara në Buxhet dhe me një gjerësi prej 4 metrave pa projekt dhe ju mundeni ta imagjinoni vet se çfarë efekti do të ketë, kështu që ne kemi filluar këtë proces dhe jemi në bashkëpunim me ministrin e infrastrukturës që ajo rrugë të ndërtohet me standarde dhe me gjerësi normale dhe të vazhdohet deri tek livadhet . Do të vazhdojmë me Impiantin dhe Kolektorin e ujerave të zeza që sipas menaxherëve është pritur 5 vite për shumë pak punë e tani janë kryer të gjitha punët dhe pronat janë dalë në pronësi të komunale dhe pagesat janë kryer e njëjta gjë është për ngrohtoren e re të Qytetit dhe do të vazhdojmë edhe me parkun ashtu siç është premtuar dhe është mëkat i madhe pse nuk janë mbjellë drunjtë sepse të gjitha e dimë se duet vite që të rriten ata drunjtë, do të filloj Projekti i Lumit Krena . Kjo qeverisje do të karakterizohet me një gjithë përfshirje me çka veç sa kemi filluar ku kemi pasur një takim dhe do të vazhdojmë me bashkëpunimin me biznese dhe komunën që të provojmë që sa më shumë kontrata të shkojnë në bizneset e Gjakovës në suaza të ligjit . Në këtë vit i kemi disa projekte të mëdha dhe në këtë vit do të dalim edhe nga ky objekt për të cilin janë kryer të gjitha procedurat edhe pse ky projekt është stërzgatur. Synim i qeverisjes sime në Gjakovë ka me qenë rritja e të hyrave rritja e investimeve gjithë përfshirja, transparenca ku të gjitha proceset do të jenë transparente. Ne nuk e kemi ndalur as një projekt të filluar nga viti i kaluar edhe pse aj buxhet ka provuar me i nis të gjitha duke u thirrur në KAB dhe praktikisht mos me kryer asgjë , andaj në rishikim do të shikojmë se çka mundemi të korrigjojmë.

Kryesuesi: E Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës

znj. Diana Qarkaxhija: Ky Dokument për nga forma është voluminoz por nga përmbajtja i ngjason komplet qeverisjes së kaluar, dhe po i referohem konkretisht Drejtorisë së arsimit ku pjesa dërmuese ka qenë në planin tim të punës dhe janë disa elementë që janë përfunduar në vitin 2017 dhe nuk duhet të zjenë vend në vitin 2018 ku ka edhe disa gabime teknike . U tha nga kryetari se projektet e mira i kemi vazhduar edhe më tutje dhe më habit fakti se një projekti i vitit 2016-2017 që Gjakovën e vuri edhe në analet e televizioneve më të mëdha botërore, që e ka promovuar sportin dhe shëndetin Projekti “ Malësia e Gjakovës” që ka pasur për fokus lidhjen Kosovë Shqipëri, dhe në këtë plan nuk është i paraparë. Nuk është i paraparë projekti i trenit që është përmendur gjatë gjithë fushatës , gjithashtu projekti i Lumit Krena vetëm është përmendur dhe nuk është i buxhetuar , si dhe projektet e branës në Lumin Drini , Maja e Kurorës, rruga e radoniqit e të gjitha

këto që janë përmendur në fushatë. Ky plan më shumë i ngjan përshkrimit të detyrave të punës se sa një plani të punës, një element tjetër është heqja nga qeveria e 19 milion euro nga Qeveria që kanë qenë të përpara për projektet e Gjakovës. Në rrugën Bujar Roka ka pasur projekt dhe ka qenë i hartuar nga DEMOS në dy faza .

Kryetari: Unë këtu do të jemi komplet në këtë mandat dhe nuk do të ketë zgjedhje, sa i përket mbjelljes ë fidanëve nuk keni mbjellasnjë e afër 700.000€ ju kanë shkuar në suficit keni pasur mjete nuk i keni shfrytëzuar, Rruga Bujar Roka deri ku ka përfunduar ka projekt ndërsa pjesa tjetër nuk ka projekt dhe kjo është e saktë , projekti Krena është e buxhetuar dhe kemi marrëveshje me Ministrin e Mjedisit e sivjet do të shpenzohen 250.000.00€ dhe do të përfundon segmenti i parë, tek maja e kurorës ka filluar në shtator të vitit pa pasur projekt me gjerësi prej 4 metra dhe është vendosur zhavorri, ne kemi hartuar projektin dhe vitin tjetër do të arrijmë tek maja e kurorës, për trenin ne i kemi 4 vite mandat dhe ne kemi biseduar me Ministrin e infrastrukturës ka fizibilitet dhe janë 8 kilometra, rruga Radoniqi jemi pajtuar që në rishikim me përfunduar projektin dhe vitin tjetër me filluar me ndërtim të kësaj rrugë , por jam i befasuar nga këto reagime të juaja sepse që 3 muaj jam kryetar dhe ju për 4 vite nuk i keni kryer këto projekte .

z. Zef Komani: Në mbledhjen e kaluar kam kërkuar nga opozita që të jenë më konstruktiv për të mirën e qytetarëve të Komunës së Gjakovës, sepse u tha nga ish drejtorie sha e DKA-së se drejtori i tanishëm i ka vazhduar projektet e mija, dhe kjo që u tha nuk është në rregull sepse arsimi e ka një kontinuitet dhe nuk mundesh me ndryshu çdo gjë, mandati i kryetarit është 4 vite dhe mos kërkon që të kryhen për 3 muaj andaj mos të dalim në foltore vetëm për të dalur ne TV, por të jemi konstruktiv dhe mos të bëjmë akuza pa bazë .

znj. Diana Qarkaxhia: Projekte e arsimit janë në vazhdimësi është e vërtetë por së paku një fjali të ndryshohet nga ajo që e kemi përdorur ne, dhe nuk është vendosur as një risi për këto katër vite, ndërsa për sa i përket trenit e të tjera nuk i pashë tek plani i punës .

Kryetari: Ne nuk po prezantojmë Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve por jemi duke diskutuar për Planin e Punës për vitin 2018 i cili plan duhet të varet nga buxheti të miratuar në vitin e kaluar .

z. Edmond Dushi: Duke e dëgjuar fjalimin e Kryetarit u binda se këtë plan Kryearti nuk e ka lexuar fare sepse ka shumë gabime si në Gramatikë si në përmbajtje dhe në të gjitha aspektet. Ne kemi marrë këtë dokument ku janë paraqitur punët ditore të drejtorive ndërsa kryetari përmendi diçka tjetër andaj ne si anëtar të kuvendit cilën duhet të bazohemi, po ju përmendi disa gabime që e dëshmojnë këtë plan ka shumë të meta bile dhe kopjime nga vitet e kaluara, në DPPA, thotë digjitalizimi i arkives fillon këtë vit shumë e mjeteve 70.000€ kjo shumë mund të kryhet edhe me këste se di si kuptohet kjo , funksionalizimi i aplikimit online te dokumenteve kjo funksionin qe disa vite, DSHP, organizimi , koordinimi dhe menaxhimi i punëve dhe detyrave në sektor nuk e di se si donë me mat këtë, pjesëmarrje në komisione kjo është punë ditore , i kem tri projekte me nr. 54, 55,56, të cilat nuk janë të parapara në buxhetin e komunës, te Sektori i trafikut propozoj që pikat për parkingje për taksi, për hapësirat gjelbëruese ka pika të ngjashme, si dhe për përgatitjen e tenderëve për drunjë dekorativ, DKRS, qëllimet e përgjithshme Jetë kulturore dhe Sportive për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjakovës, te aktivitetet tradicionale disa e kanë datën por të tjerat nuk kanë datë shpallja e sportistit të vitit është në secilin sektor krijimi i kushteve të volitëshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive qysh do të vlerësojmë se a janë krijuar këto kushte kur nuk është shënuar. Tek biblioteka numri i lexuesve çdo vit ka rënje pro ruajtje të numrit konstant të lexuesve, ndërsa më vonë është e shënuar se kemi rritje të shtuar të lexuesve andaj cila është e saktë tani si dhe kemi plot çështje të tjera të pa kuptueshëm dhe kundërthënie. Kemi tek Muzeu gjatë viti 2014 - 2015 do të organizohen së paku 2 premiera në paraqitjen e trashëgimisë. Drejtoria për punë Inspektuese ka vetëm një faqe me tredhjet rreshta në faqen tjetër me tabela nuk është bërë as llogaritje e mirë e sektorëve nëpër muaj.

Në fushatën elektorale e keni përmend trajtimin e qeneve endacak si dhe stadionin e Qytetit dhe në këtë plan pune nuk është asnjëra nga këto.

Kryetari: E kamë të qartë se Opozita duhet të thotë diçka dhe kjo është në kuadër të asaj, por nëse ju folni për këtë plan qeverisës tani këtu dhe unë që në fillim ju thashë se buxheti është miratuar nga qeverisja e kaluar, unë jam i obliguar që të punoi me këtë buxhet të paktën deri në rishikim, sepse unë kurrë nuk i kisha ndarë një projekt me vlerë 100,000€ në tri vite, për trajtimin e qeneve endacak, Qeveria e Kosovës i ka ndarë 3 milion euro por buxhetin që e keni miratuar ju nuk e keni parapara as një mjete, Stadioni nuk e keni buxhetuar ju, unë ende nuk kamë mundur me e parapa në plan të punës pa buxhet por po ju jep një lajm se qeveria e Kosovës ka kërkuar nga Gjakova që të hartoj projektin dhe në rishikim të buxhetit të mundet të futet edhe ky projekt, Sa i përket gabimeve pajtohem që duhet me u përmirësuar por duhet të keni parasysh ato që i përmenda .

z. Edmond Dushi: Unë nuk kamë marrë pjesë në miratimin e buxhetit, si dhe jam i vetishëm që në 3 muajt e parë nuk mundeni të ndërhyjni por ky është plani vjetor, unë po garantoj se sikur të ishte bërë ky dokument me objektiva të qarta dhe aktivitete të qatra nuk do të ishte bërë mbi 30 faqe .

Kryesuesi: Nëse të pengojnë projektet e DKRS-së të prezantuar ku për këtë periudhë zën vend sa 4 vite të qeverisjes së kaluar ku kanë ardhur dokumente që jemi turpëruar ne këtu dhe çështje përgjysmuar buxheti i Kulturës dhe tani dikujt nuk i vije mirë që po zhvillohen këto aktivitete .

z. Shkumbin Kastrati: Për projektet e parapara me numër 54,55,dhe 56 janë në planin tim dhe janë në buxhet në grandin qeveritar është rruga në lagjen krazhnja dhe është me kod të veçante rruga në Osek Hylë si dhe është edhe rruga e Molliqit pra është në buxhet po ju nuk e keni lexuar, mirëmbajta dhe ndërtimi i parqeve, lejohet në investime kapitale dhe është paraparë në Buxhet ndërtimi i parkut të qytetit është investim kapital dhe është parapara në buxhet, sa i përket mirëmbajtëse së Gjelbërimit dhe mbjellja e drunjtëve dekorativ këto aktivitete planifikohen përmes mallrave dhe shërbimeve sepse nuk lejohet të jenë këto ndryshe, për qenët endacak janë ndarë mjetet nga Qeveria por ne na kanë sugjeruar mos të veprojmë sepse do të veprojnë agjencioni i veterinës . Tregjet e keni një treg të dhënë në koncesion, një ekziston vendim mi kuvendit për dhënien në shfrytëzim dhe ende nuk janë kryer procedurat dhe për këtë arsye planifikimi është bërë mikste, janë edhe disa projekte që nuk janë të buxhetuar sepse kanë kaluar nga Ministria.

z. Bekim Ermeni: Nga Muaj Shkurt kemi kërkuar këtë planë dhe jemi munduar të jemi konstruktiv dhe kemi dhënë edhe kohë edhe hapësirë, Për ato që u tha nga kryetari ne e mbështesim dhe uroj që të realizohen sepse janë të mira për Gjakovën, mirëpo kemi një disëharmoni në mes asaj që u tha nga kryetari dhe dokumentit të prezantuar para nesh. Unë kamë insistuar që ato projekte ato aktivitete të jenë të realizueshëm të jenë të matëshme dhe me kohë ta kemi planin dinamik çka ka me punua kjo qeverisje, unë kamë qenë kundër se një projekt të ndahet në disa vite andaj kërkojmë që të kemi një plan se si të ndërprerët kjo . Kërkoj që ky plan të jetë i specifikuar të jetë i realizueshëm me buxhetin që e kemi, mirëpo ky plan është shumë i mangët sepse nuk i ka të dhënat e nevojshme andaj kërkojmë që të përmirësohet ky plan dhe të publikohet .

Kryetari: Unë kamë kërkuar nga Drejtoresha e DKRS-së që ti vazhdoj politikat ekzistuese edhe për këtë vit në të gjitha sektorët e kësaj drejtorie sepse buxheti na imponon planin. A ka shperputhje në mes asaj që e them unë dhe asaj që është në këtë plan është totale sepse unë nuk besoj në këtë buxhet por më është imponuar, dhe jam i bindur se Qytetarët e Gjakovës do të vlerësojnë punën e kësaj qeverisje dhe jo një plan ose shkrim akademik sepse ky plan është i imponuar, dhe unë nuk do ti ndali projektet siç ka vepruar qeverisja e kaluar e cila menjëherë me ardhjen në pushtet i ka ndalur të gjitha projekte e qeverisjes së kaluar dhe tani munden ti kemi një shumë të madhe të mjeteve borxhe sepse kontratat kanë qenë të lidhura .

Kryesuesi: Unë për hir të korrektësisë edhe ndaj jush dhe ndaj qytetarëve të Komunës së Gjakovës po ju them se ka anëtar të ish qeverisjes që po dalin sot këtu dhe kritikojnë këtë plan të punës kurse qeverisja e tyre për 3 vite nuk kanë prezantuar plan punë këtu në kuvend edhe pse e kanë pasur obligim ligjore, dhe kanë marrë vërejtje nga auditori se ish qeverisja i ka lënë pa i realizuar projekte e planifikuara dhe i kanë realizuar projekte e reja .

z. Haxhi Sejdiu: Unë dua të ndalemi tek projekti i ndërtimit të ujësjellësit të rekës së keqe e që është bërë një projekt maratonik që është nga vitit 2009, ky projekt ka prioritet dhe nuk janë ndarë mjete nga bartja e mjeteve nga viti i kaluar andaj kërkoj nga ju z. Kryetar që të na e tregoni se kur do të përfundoj ky projekt maratonik .

Kryetari: Për këtë projekt janë të zotuar 200.000€ dhe na nevojiten edhe 600.000€ zotimi është që të përfundoj në këtë vit jemi takuar me ministren e planifikimit hapësinor dhe me Kryeministrin dhe së shpeiti do të kemi memorandumin e bashkëpunimit dhe po ju premtoj se do të bëjë gjithçka është e mundur për këtë projekt.

z. Agon Batusha: Unë pajtona me disa nga parafolësit se ky plan ka shumë gabime e sidomos drejtshkrimore e nëse është kopje është tjetër çështje sepse nëse merr një kopje nga një komunë tjetër me qëllim të mirë sikur bërë Alternativa në mandatin e kaluar nga Komuna e Prishtinës është në rregull. Një vërejtje kam në DKA në një fjali ku thotë për mësimin gjatë gjithë jetës ku i ka përfshirë të gjithë gratë, fëmijët të rinjtë minoritetet dhe nuk përmenden burrat, si dhe fëmijët i ndan edhe në minoritet që nuk është në rregull po krijohet ndarje. Planet e punës në ish qeverisjen nuk janë ardhur veç në vitin e fundit me insistimin e opozitës kjo është një hap i mirë që sot e kemi këtu edhe pse me mangësi dhe vërejtje , Për projektet 3 vjeçare është e vërtet se nuk janë të mirë dhe janë jologjike për ti kënaqur apetitet e të gjithëve, andaj një vërejtje kërkohet që për vitin e tjetër të ketë një metodologji unike e jo të përdorin standarde të ndryshme. Ky plan nevojitet që për vitin e ardhshëm të bëjmë krahasime se a është përmbushur plani.

Kryetari: Pajtohem se ky plan duhet të korrigjohet sepse ata që e kanë punuar këtë planë janë ngutur për shkak të kohës së shkurtër .

z. Jeton Vorfi: Kryetari e filloj fjalimin me 26 projektet që nuk janë proceduar nga qeverisja e kaluar e që janë ato projekte që kanë qenë të bashkë financuara nga Qytetarët e komunës së Gjakovës e që janë projekte ilegale, rruga Bujar Roka ka qenë e planifikuar në dy faza , faza e parë është e kryer dhe ka qenë e financuar nga DEMOS dhe 25% bash financim nga komuna, projekti ekziston dhe do a prezantojmë në mbledhjen e ardhshme, sa i përket qarkores ne e dimë se pjesa e parë ka qenë e planifikuar nga Komuna e Gjakovës ndërsa pjesa e dytë ka qenë e aprovuar nga Ministria e Financave dhe ajo e Infrastrukturës dhe është anuluar nga z. Pla Lekaj andaj si do të realizohet ky projekt .

U tha nga kryetari se disa projekte nuk do ti kisha vazhduar, nuk është mirë të dëgjosh nga kryetari që ato projekte do ti kishte ndaluar ku janë të planifikuara të buxhetura dhe janë projekte të rregullta dhe të votuara në këtë Kuvend ne në qeverisjen e kaluar i kemi vazhduar të gjitha projektet që kanë qenë të rregullta, dhe u tha se për 4 vite nuk është punuar asgjë dhe po të ishte ashtu në Zyrën e kryetares janë 4 dekorata me nr. 1 të fituara nga puna e mirë e bërë për komunën e Gjakovës .

Kryesuesi: Projektet me participim nuk kanë qenë projekte ilegale por kanë qenë të rregullta që kanë kaluar në procedurat e prokurimit dhe ju për 4 vite nuk i keni kryer ato projekte do të kryhen mos realizimi i tyre ka qenë vërejtje në raportet e auditorit për vite me radhë andaj kjo qeverisje do ti kryej këto projekte .

z. Muharrem Musa: Po flasim këtu për projektet e pa realizuara që kanë qenë të miratuara që disa vite dhe kanë qenë në procedurë por që nuk janë realizuar nga ish qeverisja ka shumë dhe njëra prej tyre është rruga në fshatin Becë e cila është filluar që 8 vite dhe ende nuk është përfunduar e vetmja arsye është lojërat politike dhe asgjë tjetër . Sa i përket këtij plani u kritikua nga opozita dhe krejt kjo është pasojë e qeverisjes së kaluar sepse buxheti është nga ish qeverisja dhe planifikimi i projekteve është i tyre deri në rishikim .

z. Basri Komoni: Unë dola të ju prezantoj të metat e këtij plani në sektorin e shëndetësisë dhe të Mirëqenies Sociale, funksionalizimi i mjekësisë familjare në tersi si faktori themelor i shëndetit në komunën tonë pra me këtë pikë nuk e di se çfarë aktivitete do të merren me çfarë dinamike, andaj ky plan nuk i ka të specifikuar aktivitetet dhe planin dinamik.

z. Zef Komani: Unë nuk e dëgjova kryetarin që tha se unë i kisha hequr këto projekte por tha se unë nuk ndiej emocione për këtë projekte . Është e varetë që plani i punës varet krejt nga ajo se sa ki mjete, si dhe është mese e vërtetë edhe sot qeverisja komunale nuk e din sa mjete ka sepse për secilën ditë po tërheqin mjetet nga përmbaruesit privat . Në aspektin teknik ky plan është katastrofë sepse duhet të jetë unik e jo të ketë laramani në drejtori. Kam një kërkesë që të analizohet rasti i rrugës Gjon Nikollkazazi sepse një tërmet i vogël në minimum 30 shtëpi do të bijën në Erenik , sot është dëmtuar ajo shtëpi që nuk ka leje të ndërtimit, andaj duhet të ndërmerren hapat dhe të kthehet Ereniku në rrjedhën natyrale të veten rregullohet kjo çështje.

Kryetari: Plani është punuar nga administrata e kaluar komunale, sa iu përket asaj zone edhe në vitin 86 figuron ajo zonë se është erozive dhe komuna ka gabuar që ka lejuar ndërtimin në atë zonë dhe tani duhet të shikojmë se cilat janë mundësit tona për ndërhyrje dhe ka disa probleme edhe për çështje të pronave sepse disa pronarë kanë ndërtuar në pronën komunale dhe tani kemi probleme dhe me investuar në këto prona .

z. Drita Buza : Kam një pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë sepse në planin e punës së kësaj drejtorie është paraparë rishikimi i banimit social a ka mundësi ta dimë se përmes cilave procedurave do të bëhet ky rivlerësim dhe kush do ta bëjë këtë rivlerësim sepse këta përfitues kanë kaluar përmes disa procedurave që janë përzgjedhur, si dhe në pikën 10 furnizimi më i mirë i njësisë së stomatologjisë me materiale të nevojshëm si dhe ne kemi kuadro por nuk kemi mundësi financiare për ti mbuluar kërkesat e qytetarëve , andaj ju jeni drejtoreshë e shëndetësi dhe në Komunë se Gjakovës që ka të bëjë me shëndetin primare dhe ju këtu jeni marrë me shëndetësinë sekondare .

Kryetari: Unë mendoj se këtu ka probleme me komunikim sepse dhjet herë u bë e njëjta pyetje dhe dhjetë herë e bëra përgjigjeje, 12 banesa kanë qenë në dispozicion nga Komisioni i kaluar dhe i ka përzgjedhur 42 familje përfitues dhe është e domosdoshme me rishikuar dhe as një njeriut nuk ja kemi anuluar përzgjedhjen as nuk e kemi dëbuar nga ato banesa, por nuk kemi si të bëjmë ku janë zgjedhur 42 familje në 12 banesa në kohë fushate dhe tani është paraqitur ky problem. Për sa i përket stomatologjisë 4 vjet ish qeverisja i keni pas kohë për me gjet zgjidhje për mos me u shuajt Stomatologjia dhe ky shërbim është drejtë shuarjes, nuk keni bërë asgjë për shërbimin e vaksinimit përkundër e keni shkatërruar një shërbim që ka qenë më i mirë në krejt Kosovë dhe kur ka përfunduar qeverisja e juaj aj shërbim është më i dobëti në Kosovë.

Znj. Miranda Lushaj: Unë dua të diskutoi tek objektivat e përgjithshme tek drejtoria e arsimit, integrimi i arsimit special parashkollor fillor dhe të mesëm, qendrat e arsimit special nga viti 2002 janë kthye në qendra Burimore dhe gjakova nuk ka qendër burimore por i ka dy klasa të bashkangjitura, dhe në këtë plan nuk hasa në as një pikë që e trajton këtë çështje, andaj ju ftoj që ti vizitoni këta fëmijë që nuk kanë as mjete didaktiko mësimore, dhe duhet të ceket se ku duhet të integrohen në klasa të rregullta dhe duhet të kemi edhe mësimdhënës udhëtues që në komunën e Gjakovës nuk ka .

z. Basri Komoni : Me diskutimin e kryetarit u dëshmuar se nuk e njeh ligjin për banimet e veçanta në të cilin komuna ka qenë e obliguar që secilit njeri që është në atë banesë dhe nuk ka kontratë me të themeluar komisionin që të kërkojë dokumentacionin për aplikim dhe kanë ardhur mbi 200 aplikacione dhe janë përzgjedhur 42 të parët në 47 banesa dhe u tha se po e shuani stomatologjinë që dëshmon se nuk e njihni ligjin për stomatologji dhe udhëzimin administrativ që thotë se shërbimet sekondare stomatologjike mbesin në kujdesin parësor shëndetësor , dhe arsye pse ne nuk pranojmë stomatolog të ri për arsyeja se e ndalon ligji edhe se ka pasur disa pranime që janë bërë në harmoni me ligjin .

Kryetari: A po e lejon ligji apo jo se nuk po e kuptoj çfarë po thoni herë e lejon e herë jo, 12 vite kamë punuar në hartimin e ligjeve në komisionin parlamentar për legjislacion dhe nuk kamë len ligj pa lexuar, dhe këtë nuk ta ndalon Ligji por Statuti e ndalon , me çfarë ligji keni marrë ndërkohë . Tek banimi Social ju keni bërë një komision për me i nxjerrë disa prej banesave dhe me i sistemuar do të tjerë që ju keni vlerësuar se nuk i plotësojnë kushtet por nuk e keni përfunduar procesin sepse i keni pasur 12 banesa të lira dhe i keni përzgjedhur 42 përfitues, me çfarë kriterë ju e keni nxjerrë dikën nga banesa që i plotëson kushtet për banim social për me e shti dikën tjetër edhe atë në kohë të fushatës .

znj. Drita Buza: Unë kërkoja nga drejtoresha e arsimit dhe kërkoj sqarime se vlerësimi ndaj ankesave për banim social a vendos kuvendi i komunës apo Ministria e Ambienti, sa i përket planit kadrovik në stomatologji ne kemi më shumë dhe gjatë gjithë asaj kohe ne kemi qenë mirë të furnizuar me material dhe kemi në depo tepriçë të materialit .

znj. Dafina Sylja: Unë dua ta paraqes një rastë që më ka ndodhur personalisht mua, jetoj në Bllok të ri dhe e kemi shumë afër QMF në Orizë, dhe për herë të parë në atë qendër kishte furnizimin e nevojshëm me të gjitha pajisjet e obligueshëm, këtë mundeni ta vërtetoni. Gjithashtu jam shumë i kënaqur për vendosjen e kujdestarive 24 orë ë katër qendrat e Mjekësisë Familjare në Rugov , Ponoshoc , Skivjan dhe Cermjan, si dhe për çështjen e banimit social si është mundësia e komunës ose si do të veprojmë për këtë çështje mjaft të ndjeshme .

Kryetari: Për këtë vit nuk kemi asgjë të paraparë në buxhet për çështjen e strehimit social , dhe deri më tani unë kamë takuar mbi 200 familje që kanë kërkuar strehim Social dhe ka nevojë për ndërtim e këtyre banesave për strehim Social por do të shikojmë se çka do mundemi të bëjmë .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

4.Pika e katërt e rendit të ditës: Miratimi i Planit të punës së KKSB-së 2018

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Miratimi i Planit të punës së KKSB-së 2018, ky është një obligim ligjor që të miratohet plani i punës së KKSB-së, draft dokumentin e keni marrë me kohë dhe është diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së andaj e ftoj Komandantin e Stacionit Policor të Kosovës në Gjakovë z. Kristë Gjokaj që të merr fjalën.

z. Kristë Gjokaj: Ne kemi mbajtur takimin e parë të KKSB-së për këtë mandatë dhe njëra ndër pikat e rendit të ditës ka qenë edhe themelimi i komisionit për hartimin e planit të punës së KKSB-së , dhe ne jemi takuar dhe e kemi hartuar këtë dokument, ku janë paraparë 15 objektiva dhe shumë aktivitete brenda këtyre objektivave, që janë të parapara në këtë dokument i cili është miratuar në KPF. KKSB-ja është organ këshillëdhënës në aspektin e sigurisë dhe këto pika janë të përpara në këtë plan jemi fokusuar në aspektin e sigurisë, pikat kryesore që janë paraparë janë siguria e përgjithshme, siguria në Shkollë me fokus të veçantë kundër mjeteve narkotike që është edhe objektivi i paraparë edhe nga Kryeministri i vendit, shtimi i numrit të sigurisë në afërsi të shkollave, siguria në komunikacion, trajtimi i qeneve endacak, dhuna në familje është

paraparë si objektiv i veçantë dhe dua ta potencoi se dhuna në familje nuk ka rritje por ka rritje raportimi i dhunës në familje, kemi paraparë objektivat kundër ekstremizmit të dhunshëm që shpijë në terrorizëm, kemi paraparë fushata të ndryshme sensibilizuese.

Kryetari: E falënderojmë Komandantin dhe unë propozoj që këtij plani ti shtohet edhe një element që ka të bëjë me përdorimin e narkotikëve sidomos nga të rinjtë, sepse ekspertët kanë treguar se është e evidentueshme kur një i ri fillon të përdor substanca narkotike, andaj është e nevojshme që ne ti prodhojmë disa broshura që do ti shohin prindërit, mësuesit se cilat janë shenjat e para të fillimit të përdorimit të narkotikëve në mënyrë që ti parandalojmë përdorimin e kësaj substance, andaj kërkoj që të futet edhe kjo çështje në Planin e Punës së KKS-së .

z. Edmond Dushi: Unë nuk kamë asgjë kundër Kryetarit të Komunës por a po e vëreni punimin e këtij plani me atë të kaluarin.

z. Agon Batusha: Unë dua ta ngris problemin e parkingjeve që ka mungesë të tyre dhe veturat po parkohen në trotuare aty ku është e paraparë të kalojnë këmbësorët dhe mendoj se komuna dhe policia e Kosovës duhet të vendosen pengesa që e parandalojnë parkingun e veturave në trotuare dhe policia të jenë më aktive, një kërkesë tjetër është tek drejtoria e Arsimit, tek këshillat e shkollës ku janë të përbërë nga Prindërit, mësuesit dhe nxënësit , ku nxënësit në këto këshilla nuk marrin pjesë kurrë si dhe në disa shkolla mbledhjet e këshillit të shkollës nuk mbahen kurrë që është obligim .

znj. Edi Puka : Unë dua të diskutoj lidhur me pikën e 15 të këtij plani të punës , ku dje kemi pasur takimin me Komitetin për komunitete dhe jemi në dijeni se kemi shumë punë për të bërë në vetëdijesimin e pakicave për të drejtat e tyre, andaj ne të gjithë duhet të angazhohemi që të shpërndajmë broshura dhe të bëjmë një ndërlidhje me DKA, sa i përket këshillave të shkollave, unë jam pjesë e arsimit dhe këto këshilla janë funksionale dhe veprojnë në rregull në shumicën e shkollave.

znj. Dafina Syla: Ashtu si parafolësja edhe unë jam pjesë e Komitetit për Komunitete dhe kam një pyetje konkrete për ju z. Gjokaj, lidhur me braktisjen ose me mos vijimin e nxënësve të komuniteteve në shkolla, ku numri është në rritje në vazhdimësi dhe fajtor janë prindërit që vazhdimisht i angazhojnë në punë tjera dhe nuk i lejojnë me vazhdu shkollën andaj kërkojmë që këta prindër të gjobiten, dhe kërkojmë që të na ndihmoni me bashkëpunimin tuaj kur të dalim në teren në këto familje.

z. Zef Komoni: Kërkoj që premtimi nga Kryetari të mbahet dhe të ftohen policia departamenti i shëndetit primar, nga kujdesi i psikiatrisë dhe të fillohet me punë për shpërndarjen e atyre broshurave . Lidhur me çështjen e trafikut ne në Komunën e Gjakovës i kemi dy rrugë ndërkombëtare, rrugën Ura e tabakut Morinë dhe Ura e tabakut Qafa e Prushit, ku kjo e dyta për Qaf të Prushit nuk është mirë e mbuluar as nga Stacioni policor e as nga Regjioni dhe as nuk ka shënjestim të rrugëve dhe janë disa kurora që ka pasur aksidente fatale.

znj. Mimoza Shala: Sa i përket asaj që u tha nga dy parafolëse anëtare të Komitetit për Komunitete unë edhe në mbledhje të Komitetit e kam theksuar se ekziston mekanizmi që mundem ti drejtohem për këtë çështje dhe këtë përkrahje e kemi pasur edhe në të kaluarën. Unë nuk mendoj se nuk mjafton vetëm vetëdijesimi apo edukimi i fëmijëve por duhet që policia të merë hapa të mëtutjeshëm ti përcjellë deri më shtëpi, e veprime të tjera. Kërkoj që policia gjatë patrullimit në çarshinë e vjetër të hyjnë këmbë e jo me vetura sepse edhe ata po e shkelin ligjin kur hyjnë me automjete në këtë zonë .

z. Kristë Gjokaj: Lidhur me një çështje shumë më rendësi që e përmendi Kryetari ju e dini se Kryeministri i venit menjëherë pas marrjes së mandatit e ka shfaq si dukuri negative dhe menjëherë ne si polici kemi marrë

aksion për luftimin e kësaj dukurive, ne e kemi njësitin për luftimin e narkotikëve që po e bënë një punë shumë të madhe, dhe në bashkëpunim me DKA-në ne kemi shpërndarë edhe broshura nëpër shkolla dhe kemi pasur mjaft sukses . Për parkingje nuk janë ato çfarë duhet të jenë por kemi disa emergjenca që nuk po na mundëson të jemi prezentë kur do që kërkohet, nga znj. Puka lidhur e të drejtat e njeriut, kemi paraparë pikë të veçantë ku i kemi mekanizmat dhe jemi të hapur për ndihmën e kujtdoçoftë për respektimin e të drejtave të njeriut, për mos vijimin e nxënësve në shkolla nga komunitetet edhe kjo dukuri është evidente dhe ne e kemi njësinë që quhet njësia në Komunitet dhe shumë shpesh dalim në shkolla dhe identifikojmë këto brenga dhe brenda mundësive ne veprojmë në zgjedhjen e këtyre problemeve, sa i përket asaj që u tha nga z. Komani ajo rrugë është regjionale dhe mundemi edhe ne të veprojmë kështu që do të kemi parasysh këtë kërkesë, për znj. Shala çështja e fëmijëve në rrugë ne kemi vepruar shpesh i kemi dërguar në qendrën për punë sociale dhe hapa të tjerë por nuk kemi mundësi tjera për çarshinë e vjetër është problem dhe do të kemi parasysh këto kërkesa dhe sugjerime .

Kryesuesi: Pasi që nuk ka më diskutime e qes në votim Miratimin e Planit të punës së KKSB-së 2018,

Kush është: Për, Kundër, Abstenim .

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës unanimisht u votua pro. pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V e n d i m

Për miratimin e Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2018

- 1.Miratohet Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Gjakovës për vitin 2018.
- 2.Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2018.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Kryesuesi: Kërkoj 15 minuta pauzë dhe pas pauze të vazhdojmë me pikat në vazhdim.

5. Pika e pestë e rendit të ditës: Miratimi i Planit për transparence në Komunën e Gjakovës 2018.

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Miratimi i Planit për transparence në Komunën e Gjakovës 2018, draft dokumentin e keni marrë me kohë dhe është diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së është obligim ligjor që është i paraparë në Udhëzimin administrativ dhe në Rregulloren Komunale për transparencë hartimi i këtij plani.

E hapi diskutimin për kë pikë:

z. Agon Batusha: Unë kam një sugjerim teknik dhe ueb faqëja është aktive të gjithë anëtareve të Kuvendit ju ka dalur emri në këtë faqe me foto dhe grupit që i përkasim, andaj kërkojmë që të jetë edhe emaili i të gjithë anëtareve të Kuvendit .

Kryesuesi:. E qes në votim Miratimin e Planit për transparence në Komunën e Gjakovës 2018 **Kush është Për, Kundër, Abstenim .**

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro** këtij vendimi, pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

Për

Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Gjakovës për vitin 2018

1. Miratohet Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Gjakovës për vitin 2018 .
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti i Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Gjakovës për vitin 2018.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

6. Pika e gjashtë e rendit të ditës : Shqyrtimi i raportit final financiar të Komunës së Gjakovës për vitin 2017.

Kryesuesi : Për këtë pik të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës së Gjakovës për vitin 2017, kjo pikë është diskutuar edhe në Mbledhjen e KPF-së dhe sipas Ligjit për menaxhimin e financave Publike Komuna është e obliguar që më së largu deri me 31 Mars të prezantoj Informatën Vjetore Financiare në Kuvendin e Komunës, andaj e ftoj Drejtorin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z. Durim Halilaj, që ta merr fjalën.

z. Durim Halilaj : Duke u bazuar në nenin 26 dhe 47 të Ligjit për menaxhimin e Financave Publike si dhe në rregulloren e MEF 03/2013 Drejtoria për Buxhet dhe Financa prezanton pasqyrat vjetore Financiare për periudhën Janar – Dhjetor 2017.

Buxheti i aprovuar për vitin 2017 në Kuvendin e Komunës ka qenë 21.229.849,00€ e i cili ka pësuar ndryshime nga ai fillestarë, donacione dhe participime 978,729.00€, mjete të bartura nga viti paraprak 1.270,434,00€ buxheti i përgjithshëm i vitit 2017 ka qenë 23,473,289,00€.

Mjetet e alokuara nga grandit qeveritar ka qenë 17.607.865,00€, të cilat janë shpenzuar 16,973.000.00€ ose 96.39% e këtyre mjeteve dhe e kemi një suficit që ka ikur në buxhetin e Republikës së Kosovës 635.997€ ndërsa janë shpenzuar 3.031.029,00 € janë shpenzuar 2,026,574,00€ . Shpenzimet nga mjetet e bartura nga viti paraprak prej 1.270.434,00€ janë shpenzuar 1.080.000€ apo 85% e këtyre mjeteve, Nga donacionet 978,429,00€ janë shpenzuar 863,334,00€ ose 88.21% . Mjetet që kanë shkuar në Sufit nga grandit qeveritar janë nga Pagat dhe mëditjet, mallra dhe Shërbime, komunalit dhe investimet kapitale. Komuna ka realizuar të hyra vetanake në vitin 2017 në vlerë prej 3.031,029€ apo 83.28% e mjeteve të planifikuara, krahasuar me vitin 2016 kemi një rënje prej 5.4 %.

Borxhet e trashëguara fillimisht ju njoftoj se këto borxhe do ti prezantojmë në mënyrë analitike në Kuvend dhe ato janë 4.212. 865,00€ të cilat krijojnë probleme enorme për shkak të tërheqjes së mjeteve nga përmbaruesit, gjithashtu kemi edhe obligim e kontraktuese që janë në vlerë prej 9 milion euro që në total janë mbi 13 milion euro borxhe të trashëguara nga qeverisja e kaluar. Komuna ka obligime të pa inkasuar nga qytetarët dhe operatorët ekonomik mbi 8.500.00,00€. Në vitin 2017 përmes përmbarueseve janë tërhequr mbi 800.000.00€.

Kryesuesi: E hap diskutimin për këtë pikë:

Znj. Hana Zeka : Nga kryetari para dy muajve është thënë se komuna i ka 13 milion euro borxh ashtu siç u tha edhe nga drejtori, dhe ne e kemi bërë një kërkesë në MEF për borxhet që i ka trashëguar Komuna e Gjakovës dhe kemi marrë përgjigjeje se Borxhi i deklaruar nga Komuna e Gjakovës është 4.1 milion euro, pra ky është borxh i deklaruar nga Komuna në Ministrinë e Financave Ky borxh efektiv është i fryrë, sepse

janë paraqitur faktuar të viti 2012 dhe 2013 ku këto faktuara nuk kemi pasur mundësi me i paguar sepse janë të pa rregullta, dhe ky 4.1 milion kemi prezantuar faktuara nga vendimet e shpronësimit të pronave rreth 1.8 milion dhe ky nuk është borxh por është planifikim, si dhe nga drejtoria e shërbimeve publike 1.5. milion as ky nuk është borxh sepse janë projekte që janë në planifikuara në vitet në vazhdim, pra të gjitha këto nuk janë borxhe dhe nga të gjitha këto del se komuna e Gjakovës i ka borxh vetëm 766.000€ dhe nëse është borxh edhe ato 9 milion pse nuk janë dorëzuar në Ministrinë e Financave .

z. Durim Halilaj: Borxhet e vitit 2012 dhe 2013 i keni në raporte dhe i keni pasur vazhdimisht nuk janë fryrë, ndërsa sa i përket shpronësimit i keni marrë vendimet dhe është bërë vlerësimi nga Ministria e Financave dhe janë vendimet e kuvendit dhe janë procedura, janë paguar shpenzime të shpronësimeve të vitit 2015 dhe të vitit 2016 pse duhet të paguhet nëse nuk janë borxhe. Tek marrëveshjet i keni bërë marrëveshjet keni hyrë në obligime dhe nuk ju keni përmbajtur obligimeve, i keni lënë pa i paguar borxhet dhe i ka tërhequr mjetet në mënyrë të njëanshme përmbaruesi. Sa i përket borxhit të kontratave janë 9 milion që nuk i kemi përcjellë për MEF por ju kemi dorëzuar juve si anëtarë të kuvendit për me e dit se në çfarë gjendje financiare është Komuna e Gjakovës dhe këto mjete që figurojnë si borxhe nuk janë të gjitha të paraprirë as në KAB, që u tha nga ju por keni vepruar duke i përcjellë projektet nëpër vite siç është rasti i rrugëve të Skivjanit, që për çdo vit i keni paraparë dhe nuk i keni realizuar dhe tani përmbaruesi i ka marrë mjetet në mënyrë të njëanshme .

z. Bekim Ermeni: Këtij raporti i mungojnë pasqyrat financiare sepse ato auditohen dhe ato mungojnë, kemi borxhin e trashëguar ku i kemi 3 linja njëri është 4.miljon tjetër është 11,000€ dhe tjetra është 9 milion. Tek e para janë disa vendime që janë marrë nga kjo asamble komunale që nuk janë ekzekutuar ende dhe janë në proces para dhe në proces edhe paguhet këto ne po i konsiderojmë si borxhe mirëpo nuk janë borxhe faktike, u përmend objekti i personave me aftësi të kufizuara mbi 110,000€ dhe ky projekt është menduar që të paguhet nga DBF ministria nuk e ka lejuar që të merren këto mjete andaj këto mjete janë bartur në vitin 2018 dhe nuk është treguar se këto janë pikërisht këto mjete që janë bartur, andaj këto mjete janë bartur për tu paguar nuk është borxh. Elementi i tjetër është obligimi ndaj CDI-së ku DSHP, e ka paraqitur si borxh në proces, elementi i tretë është ndaj Radoniqit po ashtu në proces, që është e shënuar faza e dytë e punimeve që ende nuk është kryer pra nëse ja heqim këto borxhe del se borxh faktik i kemi 1.2 milion euro borxh real sepse ato shifrat tjera janë të manipuluar dhe janë duke e anashkaluar KAB-in që janë të planifikuara. Avance e pa mbyllur nga viti 2017 afër 11.000 €, këtu bëhet fjalë për Kodin e avancave që është tërhequr nga MEF dhe borxhet kanë mbetur, ndërsa e treta është 9 milion euro edhe ky kuvend edhe kjo qeveri komunale edhe në mandatin e kaluar po përsëriten të njëjtat ngjarje dhe varësisht nga pozita apo nga opozita po reagojmë dhe këto janë projektet e kontraktuara në vitin 2012-2013 dhe mbetja borxhit afër 2.2 milion dhe duke ju shtuar këto edhe obligimet e projekteve të mëdha po na shkaktojnë këto probleme, andaj duhet të jemi real se obligimet e marruara përmes marrëveshjeve dhe kontratave janë të parapara në KAB dhe janë të bazuara me vendime të Kuvendit dhe komuna i ka obligim me i krye. Suficit është projekti i përfunduar dhe nuk e ka paguar dhe mjetet kanë mbetur është suficit, kërkoj të formohet një listë e këto raste . Kjo ka ndodhur sepse operatorët ekonomik nuk e kanë kryer punën dhe njësia kërkuese nuk mundet të bëjë pagesën pa raport të organit mbikëqyrës .

Kryetari: Ne kemi mundësi këtu me fol dhe me jap sqarime të ndryshëm por ne duhet ta sqarojmë se çfarë do me thënë borxh është kur diçka ki me pagua më vonë dhe lista e shpronësimeve është borxh po përmendet KAB sipas jush kjo qeverisje po dashka me punë tri vite me planifikimet që i ka bërë dikush tjetër dhe kjo është anti demokratike sepse ne i kemi fituar zgjedhjet me projektet që i kemi planifikuar me i realizua, andaj mos më thuani se tek kulla e Sylejman Vokshit nuk janë borxh 1,050.000€ për shpronësim sepse i keni shpall zonë të interesit të përgjithshëm dhe i keni larguar njerëzit nga aty . Të gjitha shifrat janë të sakta dhe janë të prezantuara në dokumente financiare zyrtare dhe nuk janë parapara në vija Buxhetore e tani i merr përmbaruesi dhe ju dilni e thoni se nuk ka borxhe .

z. Bekim Jupa: Me buxhetin e kaluar është abuzuar dhe unë po ju përmendi disa fakte ju lutem shikoni tek tabela nr 8 tek shpenzimet analitike shpenzimet e telefonisë mobile në vitin 2014 janë 4113€ në 2015 kanë qenë 23,366€ pra ky është abuzim me paranë publike, shpenzimet postare në 2013 kanë qenë 12, 275€ në 2017 kanë qenë 32,264€ tek makinat fotokopjuese kemi kërkuar sqarime dhe kërkojmë të kemi të sakta sa janë shpenzuar , tek shpenzimet e veshmbathjes në 213 kemi 1500€ në 2013 kemi 13, 823 € kush i ka blerë këtë rroba ku janë shkuar kërkojmë sqarime, tek progresi i shpenzimeve kapitale në vitin 2017 janë ndarë mjetet ndërtimi asfaltimi i rrugës në fshatin Bec janë ndarë 40,000€ janë alokuar 40,000€ dhe realizimi zero ku janë shkuar këto mjete dhe pse nuk është realizuar projekti, ndërrimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Gergoc janë ndarë dhe janë alokuar 120.000€ ndërsa janë shpenzuar vetëm 21,000€ është realizuar vetëm 25% e projekti pse nuk është realizuar ky projekt dhe ku janë shkua mjetet , se nuk ka pasur menaxhim të mitre tregon edhe plani rregullues i Hollësishëm Rezina dhe Petro Nini Luarasi janë ndarë 45.000€ dhe janë alokuar kurse shpenzim i është zero euro ku janë këto mjete , ndërtim i pendës në fshatin Popoc janë ndarë 30,000€ janë alokuar ndërsa janë shpenzuar 13,000€ pse nuk është realizuar projekti , në fshatin Brovinë ndërtim i tendës janë ndarë 45, janë alokuar dhe shpenzimi 00€ ku janë shkuar këto mjete , kjo tregon se isha kryetarja mjetet i ka shpenzuar vetëm ku i ka pasur votuesit e vet , kemi edhe rrugët në fshatin Zhub dhe Rashkoc që kanë qenë mjetet janë alokuar dhe nuk janë shpenzuar, në fshatin Molliq janë ndarë 20.000€ janë alokuar dhe janë investuar 96% ku janë investuar këto mjete sepse aty nuk është kryer as një punë. Në faqen 18 ë raportit thuhet se në vitin 2017 vlen të përmendet efikasitetit i lartë në menaxhimin e buxhetit dhe këtu ka disharmoni me të gjitha to që u than deri më tani dhe më poshtë janë të prezantuar edhe pengesat siç janë tërheqja e mjeteve nga përmbaruesi dhe thesari andaj kërkoj që mos të kenë shpërputhje .

z. Muharrem Musa: Temat kryesore janë Suficiti dhe Borxhet pse kemi suficit kur i kemi të gjitha këto borxhe punët nuk janë kryer pse ka ndodhur kjo dhe kush është përgjegjës , u përend rruga në Bec janë harxhuar 60% e mjeteve dhe puna nuk është kryer . Sa i përket Shpronësimit tek Kulla e Sylejman Vokshit në vlerë 1.050,000,00€ që në mbledhjen e radhës të kemi si pik të rendit të ditës rishqyrtimin e këtij vendimi

z. Edmond Dushi: Ky është një raport financiare që mat performancën e Qeverisjes së kaluar dhe meqenëse nuk është personi kryesor që të përgjigjet në këtë raport mendoj se nuk mundem të ndryshojmë diçka, por i kam dy shqetësime, njëra është Suficiti dhe Borxhet, tek Suficiti pjesa më e madhe është tek pagat dhe unë mendoj se ka pasur vende të planifikuar dhe nuk ka pasur punësim, ndërsa për borxhe pavarësisht cila do që të jetë shuma ne duhet ti paguajmë këto borxhe dhe pyetja ime është a ka qeveria komunale strategji se si do të paguhen borxhet apo do të presim tërheqjen e mjeteve nga përmbaruesit, apo nëse ka të publikohet .

znj. Hana Zeka: Për punën e shpronësimeve u përmend tek Kulla e Sylejman Vokshit 1.5 milion dhe është 1.085,000€ dhe vlerësimi bëhet nga MEF dhe procedura është vonuar dhe te ne ka ardhur me vonës në vitin 2017 dhe nuk ka pasur mundësi me hy në buxhet dhe është planifikuar në KAB dhe është në procedurë të rregullt, banoret ende janë aty dhe kjo është situata pra këto mjete nuk mund të konsiderohen borxh.

Kryetari: Kur një qeverisje dëshiron të realizoj në Projekt fillimisht duhet të bëjë një projekt ideor pastaj bënë para masën dhe para llogaria që kalkulohet edhe vlera e shpronësimit dhe nuk mundesh të fillosh pa e ditur sa kushton, në vitin e kaluar vlerësimi për atë projekt ka qenë diku rreth 920,000€ dhe në këtë vit është 1.050.000€ dhe jo 1.5 milion, unë nuk e thashë dhe kjo është vlerësimi fillestar dhe aty nuk ka projekt se çka don me bë komuna aty dhe nuk janë banorët aty dhe mund të shkoni të verifikoni a janë apo jo, nuk është e paraparë në KAB pse po dezinformoni, pse nuk është paguar tek Nasim Bakija mjetet dhe është ndërtuar rruga pse ka ndodhur kjo .

z. Zef Komani: Ne këtu duhet të flasim me fakte dhe të jemi të sinqertë sepse na përcjellin qytetarët e Komunës së Gjakovës, kur ka thënë ish qeverisja se kemi trashëguar një borxh kamë qen i bindur se është e

vërtetë dhe sot kur po thotë z, Kryetar Ardian Gjini se kemi trashëguar borxh jam shumë i bindur se është e vërtetë dhe kemi shumë fakte. U fol nga dikush se çka është suficite është e vërtetë se Suficiti është kur kryhet puna sillet faktuarë në Komunë dhe nuk paguhet, por është suficit kur një drejtori i ka për investime kapitale mjetet dhe kryhen të gjitha procedurat e rregullta të tenderimit dhe lidhet kontrata dhe nuk e lejon me e krye punën në investimet e bujqësisë dhe kjo është një humbje dhe nuk është në rregull, si dhe suficit është kur në DKA 32.000,00 €, nga mallrat dhe shërbimet mbesin pa shpenzuar kur në shkollat e komunës kemi mbi 60.000€ borxh në rrymë, ujë dhe mbeturina.

z. Agon Batusha: Në mbledhjen e KPF-së kemi kërkuar që ky raport të zgjerohet dhe ti kemi raportet për pagesën e tatimit në pronë në mënyrë që edhe ne si anëtar të kuvendit të kemi mundësi që në bazë të atij raporti të kontribuojmë tek qytetarët për pagesën e tatimit në Peronë. Kemi një rritje 225% tek shpenzimet e shërbimeve postare, kjo rritje në këtë mënyrë është e çuditshme, si dhe kemi rritje tek shërbimet kontraktuese sigurimi 121% unë nuk e di se kemi rritje të sigurimit nëpër institucionet e komunës, kemi rritje tek shërbimet teknike, kemi rritje në shpenzimet për veshmbathje në mirëmbajtjen e ndërtesave pra kemi 10 zëra buxhetor që ka mbi 100% rritje është keq planifikim. Tek Borxhet duhet të kemi kujdes se ku po hyjmë borxh dhe për atë se a janë borxhe apo jo, do të kemi raportin e auditorit dhe e shihni se ku jemi. Kemi edhe borxhe që i kanë Komunës dhe pyetja ime është pse ndërmarrjet që janë privatizuar nuk e paguajnë borxhin në tatimin në pronë. Një pyetje për kryetarin lidhur me pagesën e një ore dore, andaj kërkojmë sqarime për këtë shpenzim.

Kryetari: Unë kamë kërkuar që të sigurohet një dhuratë me rastin e pensionimit të një punëtori të administratës Komonale dhe nuk kamë vendosur për çfarë dhurate, pra ka të bëjë me dhuratë me rastin e pensionimit.

Znj. Hana Zeka : Kryetari ka qenë edhe Ministër dhe procedurat e vlerësimit dhe të Shpronësimit i dinë shumë mirë, ndërsa tek Kulla e Sylejman Vokshit familje që jetojnë aty ende Borxh që është prezantuar këtu nuk është real është i fryrë dhe shpronësimi nuk është borxh fiktiv.

Kryetari: Ato familje janë dalë në verën e kaluar dhe shtëpitë janë rrënuar pa u kryer procedurat dhe pa u paguar parat andaj këtë e dinë të gjithë qytetarët, kështu që më mirë për ju është mos me e hap këtë temë hiq sepse do të pësoni keq dhe nuk ka projekt për aty se çfarë do të bëjë komuna në atë pronë tek ne nuk ka asgjë veç nëse e keni marrë me vete.

z. Jeton Vorfi: Pyetja ime është kështu si ka mundësi që para qytetarëve të Gjakovës i keni prezantuar 13 milion borxhe ndërsa para ministrisë i keni prezantuar 4.2. Në planin e punës në faqen nr. 3 tek projektet për shërbimet publike do të shihni se 705 të borxheve janë projekte që janë në vazhdim për vitet e radhës dhe nuk është borxh. Për shpronësime ju e dini sa shpejtë janë realizuar kërkesat e komunës dhe vlerësimin e pronës e ka bërë ministria pa dijen e komunës, si dhe për lëvizjet në administratë shpenzimet ku disa herë në Kuvend i kemi bërë disa lëvizje buxhetore për me i paguar disa borxhe të trashëguara.

Kryetari : Në ministri duhet të prezantohet fatura e këtij Subjekti sa komuna i ka borxh, ndërsa pjesa tjetër është borxh që keni filluar ti kryeni 4 vite më vonë, që nuk keni pasur të drejtë as morale e as ligjore me i paraparë një projekte për 4 vite dhe tani të na thoni këtu janë borxhe ose nuk janë borxhe.

z. Jeton Vorfi: Unë i përmenda 26 projekte të vitit 2009 dhe 2013 që kanë qenë të pa planifikuara dhe parat janë dhënë nga qytetarët që kanë filluar punimet dhe çdo gjë ka qenë ilegale dhe për këta nuk janë realizuar nga ne pra kanë qenë projekte ilegale dhe pa procedura.

Kryetari : Qysh kanë pasur mundësi me u krye procedura e prokurimit pa i kryer procedurat, dhe janë zgjedhur operatorët përmes procesit legal të prokurimit dhe janë kontratat .

Kryesuesi: Ekzistojnë Kontratat dhe mundemi të ju sigurojmë nëse ju interesojnë .

znj. Florentina Gjergjaj: Unë nuk po flas prej mesazheve që mi dërgojnë por po nisna nga shtëpia ime se mjafton me dalë te dera dhe me e parë rrugën në çfarë gjendje është dhe nuk është rregulluar që 4 vite që ka qenë i filluar nga qeverisja e Pal Lekajt dhe ju e keni ndërprerë e nëse ka qenë projekt ilegal pse në verën e kaluar ju e keni filluar të punoni në këtë projekt .

z. Agon Batusha: Unë kamë kërkuar sqarime për projektin e rreth rrotullimit tek Bakija se si ndodhi një projekt që ka qenë i planifikuar 300.000€ dhe pas shpronësimit u bë 900.000€ dhe nga ish Kryetarja dhe ish Kryesuesi më është ndërprerë debati dhe ende komuna është në obligim financiar për këtë projekt , andaj jam i kënaqur se kam qenë opozitë .

Kryesuesi: Meqenëse se nuk ka diskutime të tjera dhe kjo pikë e rendit të ditës nuk votohet kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës dhe e mbylli diskutimin për këtë pikë .

7. Pika e shtatë e rendit të Ditës : Bartja (rialokimi) i buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin 2018.

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Bartjen (rialokimin) e mjeteve buxhetore të pashpenzuara nga viti i kaluar 2017, në buxhetin e vitit 2018, materialin e keni marrë me kohë dhe e keni parë se ku do të riallokohen ato mjete andaj e ftoj Drejtorin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z. Durim Halilaj, që ta merr fjalën .

z. Durim Halilaj: Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Gjakovës kërkon të shqyrtoj dhe miratoj bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti 2017 në vlerë prej 1.194.640,64 € në Buxhetin e vitit 2018, dhe e kemi bërë harmonizimin e këtyre mjeteve sipas këtyre të dhënave Mallra dhe Shërbime 114.674.84 €, Shpenzime Komunale 15,817,20 €, Subvencione 61.213,79 €, Shpenzime kapitale 1.002.934,81 € **Total 1.194.640,64**

Kryesuesi: E Hapi diskutimin për këtë të pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi: E qes në votim, Bartjen (rialokimin) e mjeteve buxhetore të pashpenzuar nga viti i kaluar 2017 në buxhetin e vitit 2018, sipas dokumentit të prezantuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, **kush është: Për, kundër, Abstenim** . Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua kështu : 29 pro , 0 kundër dhe 1 abstenim , pas votimit të bërë Kuvendi e miratoj këtë :

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, për bartja e mjeteve të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2017, në buxhetin e vitit 2018, në vlerë prej : **1.194.640,64 €**, sipas tabelës për shpërndarjen në këto kategori ekonomike:

1. Mallra dhe shërbime	114.674.84 €.
2. Shpenzime Komunale.....	15,817,20 €
3. Subvencione.....	61.213,79 €
4. Shpenzime kapitale	1.002.934,81 €
Totali.....	1.194.640,64 €

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të angazhohet për realizimin e të gjitha procedurave lidhur me bartjen e mjeteve të pa shfrytëzuara të hyrave vetanake, nga viti 2017 në vitin 2018, në vlerë prej; **1.194.640,64 €**, sipas shënimeve të tabelës së shpërndarjes, të evidentuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabelat për bartjen e mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2017 në vitin 2018.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

8. Pika e tetë e rendit të Ditës: Themelimi i Komitetit për Shërbime Publike (KPSH)

Kryesuesi: Komitetit për Shërbime Publike ka qeni i themeluar edhe në mandatin e kaluar dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm sidomos për bashkëpunimin me organizata dhe përfitimin e projekteve , i cili është angazhuar në mbikëqyrjen e projekteve dhe në gjetjen e formave për trajtimin e mbeturinave dhe ruajtjen e oazave të gjelbëruara, ky komitet i ka 5 anëtar andaj kërkoj që ti prezantoni nga një kandidat të 5 partitë AAK, PDK , LDK, VV, dhe PSHDK ,dhe kërkojmë të respektohet kriteri gjini dh enë komitetin për ankesa do të jenë AAK dhe Alternativa , kërkojmë që ti prezantojnë kandidatët , nga AAK Albina Sadrija , nga PDK Bashkim Gashaj, nga VV, Lirika Komoni , nga LDK-ja Sadik Hoti, nga PSHDK, Arijeta Gjokalaj.

E hapi diskutimin për këtë pikë

Kryesuesi: E qes në votim, miratimin e Komitetit për Shërbime Publike (KPSH) e këtë përbërje nga AAK Albina Sadrija , nga PDK Bashkim Gashaj, nga VV, Lirika Komoni , nga LDK-ja Sadik Hoti, nga PSHDK, Arijeta Gjokalaj., **kush është për , Kundër , Abstenim .**

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua kështu : 23 pro , 0 kundër dhe 6 abstenim , pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti për Shërbime Publike i Komunës së Gjakovës me këtë përbërje:

1. znj. Albina Sadrija , përfaqësuese e AAK-së.
2. z. Bashkim Gashaj, përfaqësues i PDK-së.
3. znj. Lirika Komoni, përfaqësuese e VV-së.
4. z. Sadik Hoti, përfaqësues i LDK-së.
5. znj. Arieta Gjoklaj, përfaqësues e PSHDK-së .

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

9. Pika e Nëntë e rendit të ditës : Themelimi i Komisionit të Ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale .

Kryesuesi: Themelimi i këtij komisioni është një obligim Ligjor që rrjedh nga Ligji për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale ,i cili ka për obligim që të bëjë shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me kërkesat që behën kundër procedurës për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim. Ky komision duhet ti ketë gjithsejtë 5 anëtar 2 nga Kuvendi 2 nga Ekzekutivi i komunës dhe 1 nga shoqëria civile , andaj kërkojmë nga AAK që ta prezantoj Kandidatin e tyre

Nga AAK propozohet z. Shaban Luma , nga Alternativa znj. Diana Qarkaxhija,. Nga ekzekutivi janë propozuar znj. Teuta Vokshi, dhe znj. Limnije Shllaku , nga Shoqeria Civile Xhovalin Nikollbibaj -Jurist

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi: E qes në votim, miratimin e kërkesës për formimin e Komisionit të Ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale me këtë përbërje z. Shaban Luma , znj. Diana Qarkaxhija, znj. Teuta Vokshi, dhe znj. Limnije Shllaku , z. Xhovalin Nikollbibaj . **kush është për , Kundër , Abstenim .**

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua kështu : 27 pro , 1 kundër dhe 2 abstenim , pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Gjakovës, në këtë përbërje:
 1. z. Shaban Luma, anëtar i Kuvendit të Komunës.
 2. znj. Diana Qarkaxhija, anëtare e Kuvendit të Komunës.
 3. znj. Teuta Vokshi, anëtare e Ekzekutivit.
 4. znj. Lumnije Shllaku, anëtar i Ekzekutivit .
 5. z. Xhovalin Nikollbibaj, anëtare e shoqërisë civile .
2. Komisioni i përshkruar në pikën paraprake ka mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës, ndërsa kryesuesi i këtij komisioni zgjidhet me shumicë të votave të anëtarëve të komisionit .

10. Pika e dhjetë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve për Teatrin e Qytetit “Hadi Shehu” në Gjakovë në Vlerë prej 26.000.00€.

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve për Teatrin e Qytetit “Hadi Shehu” në Gjakovë në Vlerë prej 26.000.00€, kjo kërkesë ka ardhur nga DKRS-ja, drejtoresha znj. Saranda Hyseni për arsye subjektive nuk është prezent andaj mundemi të bëjmë sqarime e nevojshme dhe e kemi edhe përfaqësuesin e DKRS-së prezent materialin e keni marrë me kohë kështu që e hapi diskutimin për këtë pikë.

znj. Mimoza Shala: Fillimisht dua ta theksoj se ne jemi pro kësaj pik por unë kamë një pyetje për drejtoreshën se kamë pasur një takim me këshillin e lartë të Teatrit ku vendoset për dramat dhe në dramën e fundit ka përfituar një zonjë këshilli ka qenë ku ndër andaj kush e ka marrë vendimin kisha kërkuar sqarime për këtë çështje .

znj. Dafina Sylja: Partia Demokratike e Kosovës kemi qenë çdoherë në mbështetje të artit dhe Kulturës në Përgjithësi dhe të teatrit në Veçanti ku duhet të theksojmë se me krenari ky teatër e mban emrin e të madhit Hadi Shehu . Ne duhet të jemi të kujdesshëm sepse aty ka disa njerëz që punojnë me nderë dhe disa që rrinë nën hije dhe i marrin meritat e të tjerëve, andaj ky planë mua më duket i mangët dhe kamë disa pyetje, këtu ceket se do të jenë 4 premiera brenda vitit 40 repriza, si dhe 18 repriza në qendra të tjera të Kosovës dhe nuk ceket as një emër i projekteve se a do të jen drama , shaje për fëmijë apo çfarë shfaqje do të jenë, si dhe 18 shfaqje jashtë qytetit më duket numër i madhe, si dhe për realizimin e projekteve teatrore artistike jashtë Kosovës nuk është cekur vendi as data për këto festivale me karakter kombëtare dhe Ndërkombëtare . Si dhe është paraparë që këto shfaqje ti përcjellin 12,600 shikues dhe nëse bileta kushton nga një euro kush i inkason ato mjete ose ku mentën këto mjete .

Kryetari: Në Fillim kamë kërkuar nga drejtoresha që pjesën më të madhe të planit të punës me vazhdua , dhe ne do të përpjekemi që të bëjmë një transformim të Pallatit dhe teatrit në mënyrë që teatri të krijoj të hyra edhe vetë mirëpo për këtë duhet të presim zgjidhjet ligjore , dhe planifikim ndoshta nuk është i saktë dhe e dimë se ndoshta këto shfaqje janë shumë por do të provojmë se sa mundemi me i realizuar, dhe unë kamë ide që Pallatin me ja dhënë Teatrit që të krijoj të ardhura vetë.

z. Zef Komani: E përkraha iniciativën e kryetarit që Pallati i Kulturës dhe Teatri me u funksionalizuar, dhe pajtona me znj. Sylja që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës kur të jetë prezentë edhe Drejtoresha këtu sepse ne i kemi ndarë 45,000€ për Vllaznim dhe tani edhe këto për teatër mbi 65% të buxhetit të kësaj drejtorie u shpenzua vetëm për dy sektor dhe ne mundemi të ja aprovojmë që të vazhdoj me disa shfaqje ndërsa për këtë pikë të kemi në një mbledhje të radhës . Për pikat e radhës i kemi 4 pika dhe kërkoj që në parim ti diskutojmë të gjitha dhe në votim të hedhen një nga një .

Kryetari : Nuk është çështja vetëm tek teatri por ata mbahen gjallë nga këto mjete dhe mbledhja tjetër është edhe një muaj dhe kërkoj që kjo pikë të kaloj në këtë mbledhje dhe mundemi të kërkojmë sqarime nga drejtoresha për këtë pikë në një mbledhje të radhës .

Kryesuesi: E qes në votim, Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve për Teatrin e Qytetit “Hadi Shehu” në Gjakovë në Vlerë prej 26.000.00€. **kush është: Për, kundër, Abstenim.**

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **u votua kështu : 27 pro , 0 kundër dhe 1 abstenim.** Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

Për ndarjen e subvencioneve Teatrit të Qytetit të Gjakovës “ Hadi Shehu” për vitin 2018 në vlerë prej 26.000,00€.

1. Aprovohet kërkesa për ndarjen e Subvencioneve në vlerë prej 26.000,00€ Teatrit të Qytetit të Gjakovës “ Hadi Shehu” për vitin 2018.
2. Mjetet e financiare në vlerë prej 26.000.00€ të mirrën nga kategoria e Subvencioneve në Buxhetin e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.
3. Mjetet e përshkruara në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të shfrytëzohen për realizimin e programit të Teatrit të Qytetit të Gjakovës në bazë të kërkesave nga Plani Vjetor i Teatrit për vitin 2018 .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

11.Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës : Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 910/0, Zk Firzë në Sipërfaqe S=13.52m² për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi kërkesën e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 910/0, Zk Firzë në Sipërfaqe S=13.52m² për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2), andaj e ftojme drejtorin e DUMM-së z. Arben Bakalli që të bëjë sqarimin e kësaj pike

z. Arben Bakalli: Pran drejtorisë për Urbanizëm kanë ardhur 5 kërkesa nga ana e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale për vendosjen e stabilimenteve shpërndarëse të energjisë elektrike, të cilat do të shërbejnë për ndarjen parciale të daljes ku sipas nevojës manipulohet me ndërprerjen e fuqia brenda stabilimentit e jo si deri me tani përmes ndarësit ajror ku do të mundësoj ndërprerjen vetëm aty ku ndodhet prishja e jo të ndërkrehet për të gjithë banorët e asaj dalje , i kemi 5 kërkesa të cilat po i prezantoj dhe kërkesa e parë e KEDS-it është në zonën kadastrale Firëz me nr. të parcelës 910/0 30.52m² për vendosjen e stabilimenteve shpërndarës të dimensionit 2.6 me 5.2 . kërkesa e dytë është për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 164/0, Zk Trakaniq në Sipërfaqe S=13.52m² për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2). Kërkesa e tretë është për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1186/0, Zk Cermjanë në Sipërfaqe S=13.52m² për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2). Kërkesa e tretë është për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1116/2, Zk Gjakovë qytet në Sipërfaqe S=13.52m² për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2), Kërkesa tjetër është për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 113/0, Zk Pjetërshan në Sipërfaqe S=13.52m² për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë .

Znj. Mimoza Shala : Edhe pse është e nevojshme që të intervenohet në këto zona që po kërkohet pyetja ime është se a është dashur që këto kërkesa të kalojnë nëpërmjet komisionit që e ka formuar Kuvendi , sis dhe pyetja tjetër ka të bëjë atë se komuna po ja jep pronat një kompanie private pa as një kompensim .

Kryesuesi: Ligji për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale e lejon pa kaluar në procedura për dhënien e pronave kur k a të bëjë për Energji dhe këto stabilimente është e nevojshme të vendosen sepse në disa vende janë të vendosura por tani do të vendosen me të përsosura dhe më të sigurta .

Znj. Mimoza Shala: KEDS-i është i obliguar që obligimet dhe shërbimet të ja siguroj konsumatorit sepse paguhet dhe konsumatori e paga në për këtë shërbim andaj unë mendoj se nuk duhet që këtë ta bëjmë praktik të shpeshtë .

Znj. Dafina Syla: Ne kemi qenë të gatshëm që çdo herrë ti aprovojmë kërkesa të KEDS-it por është e nevojshme që edhe këta të na i ofrojnë shërbimet adekuate dhe me rregull , andaj unë kam një kërkesë nga Familja Prushi në rrugën Petro Nini Luarasi, e cila familje e ka një shtyllë betoni mu në mes të oborrit dhe kanë kërkuar që disa vite me radhë që të bëhet dislokimi i kësaj shtylle të betonit e cila është jashtë funksionit dhe shkakton rrezik për këtë familje .

z. Muharrem Musa : Unë kërkoj që KEDS –i të ketë mirëkuptim meqenëse ne po i përgjigjemi zakonisht me përgjigjeje pozitive andaj duke u nisur nga gjendje faktike në të cilën ndodhen rrejt elektrik, kërkojmë që të investojnë në rrejt në tërë territorin e Komunës së Gjakovës.

Kryesuesi: E qes në votim, kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 910/0, ZK Firzë në Sipërfaqe S=13.52m² për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2), kush është Për , Kundër , Abstenim .

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **u votua kështu :22 pro , 0 kundër 4 abstenim** . Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë

V E N D I M

Për dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim

1. Aprovohet kërkesa e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në kohëzgjatje prej 99 viteve, pa kompensim material, në pjesën e ngastrës kadastrale me nr.910/0 ZK Firzë , në pronësi PSH. “Rrugë Publike” për vendosjen e Stabilimentit Shpërndarës të dimensionit (2.6x5.2) në Sipërfaqe $S=13.52m^2$.
2. Autorizohen organet e administratës komunale që të ndjekin procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim KEDS-it, pronën e cekur në pikën e 1-rë të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës .

12. Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës : Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 164/0, Zk Trakaniq në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi kërkesën e së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 164/0, Zk Trakaniq në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi: E qes në votim, miratimin e kërkesës së për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 164/0, Zk Trakaniq në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2). **kush është për , Kundër , Abstenim .**

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **u votua kështu :22 pro , 0 kundër 5 abstenim** . Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë:

V E N D I M

Për dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim

1. Aprovohet kërkesa e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në kohëzgjatje prej 99 viteve, pa kompensim material, në pjesën e ngastrës kadastrale me nr. 164/0, ZK Trakaniq, në pronësi PSH. “Rrugë Publike” për vendosjen e Stabilimentit Shpërndarës të dimensionit (2.6x5.2), në Sipërfaqe $S=13.52m^2$.
2. Autorizohen organet e administratës komunale që të ndjekin procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim KEDS-it, pronën e cekur në pikën e 1-rë të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës .

13. Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës : Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1186/0, Zk Cermjanë në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi kërkesën e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1186/0, Zk Cermjanë në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi: E qes në votim, miratimin e kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1186/0, Zk Cermjanë në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2). **kush është për , Kundër , Abstenim .**
Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **u votua kështu :22 pro , 0 kundër 5 abstenim .** Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë:

V E N D I M
Për dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim

1. Aprovohet kërkesa e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në kohëzgjatje prej 99 viteve, pa kompensim material, në pjesën e ngastrës Kadastrale me nr. 1186/0, ZK Cërmjanë në pronësi PSH. “ Shkolla Filllore Vllazrimi” (tani SHFMU “Ali Hasi” Cërmjanë” për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2)m, në sipërfaqe $S=13.52m^2$.
2. Autorizohen organet e administratës komunale që të ndjekin procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim KEDS-it, pronën e cekur në pikën e 1-rë të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës .

14. Pika e katërbëdhjetë e rendit të ditës : Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1116/2, Zk Gjakovë qytet në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi kërkesën e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1116/2, Zk Gjakovë qytet në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2). **Kryesuesi:** E hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi: E qes në votim, miratimin e kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1116/2, Zk Gjakovë qytet në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2). **kush është për , Kundër , Abstenim .**
Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **u votua kështu :22 pro , 0 kundër 5 abstenim .** Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë:

V E N D I M
Për dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim

1. Aprovohet kërkesa e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në kohëzgjatje prej 99 viteve, pa kompensim material, në pjesën e ngastrës Kadastrale me nr. 1116/2, ZK Gjakovë qytet në pronësi PSH. Kuvendi Komunal, për vendosjen e Stabilimentit Shpërndarës të dimensionit (2.6x5.2)m, në Sipërfaqe $S=13.52m^2$.
2. Autorizohen organet e administratës komunale që të ndjekin procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim KEDS-it, pronën e cekur në pikën e 1-rë të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës .

15. Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 113/0, Zk Pjetërshan në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi kërkesën e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 113/0, Zk Pjetërshan në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi: E qes në votim, miratimin e kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 113/0, Zk Pjetërshan në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2) **kush është për , Kundër , Abstenim .**

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **u votua kështu :22 pro , 1 kundër 4 abstenim .** Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë:

V E N D I M **Për dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim**

1. Aprovohet kërkesa e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në kohëzgjatje prej 99 viteve, pa kompensim material, në pjesën e ngastrës kadastrale me nr. 113/0, Zk Pjetërshan, në pronësi PSH. “Shkolla Filllore Qemajl Bakija- Dol” (tani SHFMU “Anton Çeta”) për vendosjen e Stabilimentit Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2)m, në Sipërfaqe $S=13.52m^2$.
2. Autorizohen organet e administratës komunale që të ndjekin procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim KEDS-it, pronën e cekur në pikën e 1-rë të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës .

16. Pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës : Të Ndryshme

Kryesuesi: Për këtë pikë e kemi kërkesën nga drejtorisë për Financa që kanë kërkuar lëvizjen e mjeteve nëpër nën kodë buxhetore në Drejtorinë e Arsimit që të mbulimin e minuseve në paga në DKA , andaj për sqarime të më tejme e ftojme Drejtorin e drejtorisë për Buxhet dhe Financa z. Durim Halilaj që të na jep sqarime të mëtejme.

z. Durim Halilaj: Me kërkesën e drejtorisë Komunale të Arsimit kemi bërë harmonizimin e brendshëm në Kategorinë Paga me qëllim të mbulimit të minusit në arsimin e mesëm Transferet nga fondi (10), Grandi Qeveritar – Pagat dhe Mëditje , Nga Arsimi (920) nën-programi Administratë (92080) shuma prej - 4,000.00 €, Nga Arsimi (920) nën-programi Arsim Parashkollorë dhe Qerdhe (kodi92510), shuma prej 7,000.00 € Nga Arsimi (920) nën-programi Arsim Fillor (Kodi 93450) shuma prej 15,000.00€ Totali i këtyre bartjeve – zbritjeve është (26.000,00 €), Kjo shume në vlerë prej 26.000,00€ transferohet në Programet 920 , nën-programin 94650-arsimi i Mesëm .

z. Bernard Frrokaj: Kjo është një kërkesë për ndryshim në pagat e arsimit të mesëm që ka minuse ndërsa në pagat e mësimi fillor ka tepër kështu që kërkohet ky ndryshim dhe është brenda drejtorisë kjo ndodhë për arsyes të pushimeve të lehonisë dhe të zëvendësimit me mësimdhënës të ri që po detyrohemi me i paguar dy persona kjo është arsyeja.

znj. Drita Buza: Në pikën e tetë të rendit të ditës ishte një nxitim tek themelimi i komitetit të shërbimeve Publike

Kryesuesi: Fillimisht ta përfundojmë këtë pikë dhe pastaj flasim për këtë temë. E qes në votim, miratimin e kërkesës së drejtorisë për Buxhet dhe Financa, për rregullimin e ndarjeve Buxhetore te organizatës buxhetore, Grandi Qeveritar, fondi (10) pagat dhe mëditjet nga nën-programet e Drejtorisë së Arsimit **kush është për , Kundër , Abstenim .**

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro .** Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, për rregullimin e ndarjeve Buxhetore te organizatës buxhetore, Grandi Qeveritar, fondi (10) pagat dhe mëditjet nga nën-programet e Drejtorisë së Arsimit të listuar në të dhënat vijuese:

Transferet nga fondi (10), Grandi Qeveritar – Pagat dhe Mëditje

1. Nga Arsimi (920) nën-programi Administratë (92080) shuma prej -4,000.00 €, ,
2. Nga Arsimi (920) nën-programi Arsim Parashkollorë dhe Qerdhe (kodi 92510), shuma prej 7,000.00€
3. Nga Arsimi (920) nën-programi Arsim Fillor (Kodi 93450) shuma prej 15,000.00€

Totali i këtyre bartjeve – zbritjeve është (26.000,00 €),

Kjo shume në vlerë prej 26.000,00€ transferohet në Programet 920 , nën-programin 94650-arsimi i Mesëm .

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen Zyrtare të Komunës së Gjakovës .

znj. Drita Buza: Në pikën e tetë të rendit të ditës ishte një nxitim tek themelimi i komitetit të shërbimeve Publike në përbërje ishin të gjitha partitë politike dhe pse ne nuk kemi përfaqësues, pse ka ndodhur kjo .

Kryesuesi: Të gjitha subjektet politike duhet të përfaqësohen në komisione dhe komitete dhe ju si alternativë jeni të përfaqësuar në të gjitha komitetet dhe komisionet dhe i keni 2 përfaqësues në KPF jeni të balancuar me AAK si parti më e madhe andaj nuk keni mundësi të jeni të përfaqësuar në të gjitha por kemi bërë një kombinim që është gjitha në Kuvend të jenë nëpër komisione kjo është arsyeja .

z. Zef Komani: Në fillim të mbledhjes unë kamë kërkuar nga të gjithë anëtarët e Kuvendit që të nxjerrim një deklaratë lidhur me arrestimin e natave të Kolegjit Turk kështu që tani jemi njoftuar qeveria qendrore i ka marrë masat e nevojshme dhe i ka bërë disa shkarkime andaj unë tërhiqem nga ajo kërkesë duke ju falënderuar për gatishmërinë e juaj.

z. Haxhi Sejdiu : Kamë një kërkesë për drejtorin e Shërbimeve Publike , që sa herë që ka të reshura në Fshatin Racaj shkaktohen përmbajtje dhe kjo ndodhë për arsye se uji që grumbullohet nga ë reshurat nuk ka kapacitet që të kalojë nëpër gypin që është në kanal por shkakton përmbajtje e kjo rendohet edhe më shumë kur e dimë se ky fshat e ka ujin e pijes nga pusët, andaj kërkoj që të intervenoni në këtë fshat .

znj. Mimoza Shala: Edhe ne një mbledhje kam kërkuar se disa rrugë kanë nevojë urgjente për ndriçim, dhe kam dy pyetje për drejtorin e arsimit , e para ka të bëjë për 4 nxënës nga fshati Netic që nuk kanë transportin e siguruara a jeni ka mundoheni që ti bëni zgjidhje , si dhe kërkojmë që rregulloret e brendshme që janë në shkollë ti përcjellni tek prindërit dhe të jenë të njoftuar edhe prindërit me përmbajtjen e tyre.

z. Bernart Frrokaj: Sa i përket atyre nxënësve në vitin e kaluar kur ka qenë tenderi nuk ka ofertuar as një kompani për bartjen e tyre dhe tani jemi duhur u munduar që ti gjejmë një zgjidhje për ata nxënës, sa i përket kërkesës së dytë është e mundur dhe do të realizohet .

z. Shkumbim Kastrati: Ne kemi intervenuar një pjesë në atë fshat , dhe tani jemi në fazën e tenderimit për mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe do të bëjmë përpjekje që të bëjmë zgjedhje për këtë çështje , për ndriçimin publik e kemi një situatë jo të favorshëm financiare dhe jemi në minus por Komuna i ka ndarë 70.000€ nga

mjetet e bartura dhe kërkojmë nga DUMM kur të lëshohen lejet për ndërrimit të shtyllave nga KEDS që të kushtëzohet me rivendosjen e rrjetit të Ndriçimit Publik .

z. Shaban Luma: Së bashku me anëtarin tjetër të Kuvendit nga Dushkaja z. Muharrem Musa kemi pasur një takim me Drejtorët e shkollave të këtij regjioni dhe i kemi dëgjuar kërkesat dhe shqetësimet e tyre dhe si më të rëndësishmet ishin ndërtimi i rrugës nga rruga kryesore deri tek shkolla në Bardhaniq në gjatësi afër 300m , si dhe shqetësim tjetër nga drejtori i shkollës në Jablanicës ishte ndërtimi i rrugës deri tek shkolla afër 800 metra andaj kërkojmë që të ndërhyhet në këtë rrugë , shqetësim tjetër ishte se njejt sanitare në Shkolla ishin të dëmtuara dhe kërkohet renovimi i tyre si dhe kërkesa tjetër e të gjithëve ishte ndërtim i një palestre sportive në Qendër të fshatit Cermjan . Shqetësim tjetër për të cilin është në dijeni edhe drejtori i Shërbimeve Publike për dëmtimin e rrugës në këtë fshat me çka kërkojmë që të intervenoni për riparimin e kësaj rrugë dhe qytetarët e kësaj anë të kalojnë lirishtë në të sepse është bërë e pa kalueshëm nga shembjet që kanë ndodhur për shkak të reshjeve të fundit .

z. Bekim Jupa: Tek pikat e ndryshme dua ta ngris një çështje për të cilin kemi biseduar disa herë në Zyrën tuaj z. Kryesues , Ligji për Protokollin e shtetit obligon që fotografia e Presidentit të jetë e vendosur, andaj kërkojmë që të vendoset sepse që disa muaj vazhdimisht kemi kërkuar që të respektohet ligji .

znj. Edi Puka: Unë ka më një shqetësim për drejtorin e DUMM-së, dhe meqenëse nuk është prezent po të trajtohem ty z. Kryetar, lidhur me një shqetësim të banorëve të Lagjes Orize lidhur me lejen e ndërtimit të një objekti P+8 në këtë lagje andaj kam 4 pyetje , a është në plan rregullativ Urban , dhe nëse nuk është si janë përcaktuar kushtet e ndërtimit , a paraqet pengës për rreth rrotullimin, si dhe janë marrë parasysh shqetësimet e banorëve dhe ka pasur reagime edhe nga kompania Dukagjini nuk ka as gjë personale por kërkoj përgjigjeje të saktë .

Kryetari : Sa i përket përqindjes së objektit është më pak se 5 0% baza e objektit pra i plotëson këto kushte, për rreth rrotullimin nuk paraqet as një pengesë sepse është e tërhekur mjaftueshëm , ndërsa sa i përket ankesave të banorëve i kemi shqyrtuar të gjitha elementet dhe është në kuadër të lejueshmes, dhe objekti mbrapa është i të njëjtit etazhitet .

z. Edmond Dushi: Kam një pyetje për Drejtorin e Shërbime Publike , lidhur me rrugën Shefki Shacivari kur parashihet që të bëhen riparimet e atyre gropave se janë shumë të rrezikshëm , si dhe propozoj që të në disa pjesë të qytetit të vendosen tabela njoftuese për njoftimet e të vdekurve sepse po vendosen gjithkund dhe po dëmtohen drunjtë.

z. Shkumbim Kastrati: Rrugën Shefki Shacivari nuk kemi bërë riparime për arsye se ka pasur dëmtime nga reshjet sidomos nga rruga e çabratit dhe së shpejti do ti evitojmë ato prishje, në fshatin Cermjan jemi në dijeni dhe ka shembje por do të presim përmirësimin e kohës dhe do të shikojmë se çfarë mundemi të bëjmë, për fsh. Bardhaniq jemi në procedurë të vazhdimin të rrugës Bardhaniq Dashinoc dhe kemi vendosur që ta dërgojmë rrugën deri tek shkolla sepse nuk është rrugë e gjatë .

Kryetari: Unë paraprakisht ju uroj të gjithë besimtarëve katolik festen e Pashkëve .

Kryesuesi: Faleminderit Kryetar edhe ne ju bashkëngjitëm urimit duke ju uruar të gjithë besimtareve Katolik Festa e Pashkëve .Mbledhja u shpall e mbyllur në ora 15:40 .

Procesmbajtës

Burim Bajrami

Kryesuesi i Kuvendit

z. Anton Shala